



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 33, Datë 26/01/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesa nr. 133, datë 13.10.2017, e Znj. E. Gj., ku pretendohet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, racës (egjiptiane), përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Znj. E. Gj. ka përfunduar arsimin e mesëm dhe ka aplikuar për të ndjekur studimet e larta pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2017-2018. Nëpërmjet shkresës nr. 501/4, datë 08.09.2017, Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale i ka përcjellë nënës së ankueses, shkresën nr. 501, datë 08.09.2017, e Kryetarit të Komisionit *ad hoc*, që ka marrë në shqyrtim kandidatët nga kategoritë e veçanta. Referuar kësaj përgjigjeje, ankuesja rezultoi e shpallur jo fituese. Duke qenë se Znj. E. Gj. i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara¹, si dhe është anëtare e komunitetit egjiptian² pretendon se mund të kishte fituar të drejtën për të ndjekur studimet e larta pranë këtij fakulteti, duke përfituar nga kuotat e veçanta që janë vënë në dispozicion për këto kategori individësh. Ankuesja shton se ajo dhe nëna e saj kanë dërguar ankesa të veçanta pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por ky institucion nuk

¹ Referuar Vendimit nr. 1333, datë 28.03.2017, të KMCAP-së.

² Referuar kartës së anëtarësisë nr. 503, të lëshuar në datën 09.01.2017, nga Shoqata Kombëtare “Sfinksi” e Minoritetit Egjiptian të Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim.

i ka kthyer përgjigje. Në këtë kontekst, ajo pretendon të jetë diskriminuar për shkaqet e sipërpërmendura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës. Ankuesja kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, duke patur parasysh statusin e saj, si person me aftësi të kufizuara, për të vazhduar studimet e larta pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

☐ Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 133, datë 13.10.2017, e Znj. E. Gj., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

☐ Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Znj. L. N., Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Z. E. R., Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës, me shkresën nr. 982/2, datë 27.10.2017, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Z. E. R., Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale, pranë Universitetit të Tiranës dërgoi pranë Komisionerit, shkresën nr. 982/3, datë 03.11.2017, ku parashtrohen sqarimet përkatëse mbi rastin në fjalë.

Sipas shkresës në fjalë, Komisioneri bëhet me dije në lidhje me faktin se në Kreun VI/2, të Udhëzimit nr. 18/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018” janë parashikuar procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Preshevë, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë (IAL) për vitin akademik 2017-2018.

Në pikën 1, të Kreut VI/2 të këtij Udhëzimi është përcaktuar periudha e aplikimit në datat 21-26 gusht 2017, për kategoritë e mësipërme, ndërkohë që në pikën 3 të po këtij kreu parashikohet: “Aplikimi të kryhet vetëm nga ata kandidatë që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe ngaçdo person ose burim tjetër”.

mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 19.04.2017, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018””.

Specifikisht në pikën 3, të Vendimit të sipërpërmendur parashikohet, se për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm, nota mesatare minimale për t’u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), për vitin akademik 2017-2018, të jetë 6 (gjashtë). Nota mesatare për t’u pranuar në institucionet e arsimit të lartë përlllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e treguesve të mëposhtëm: a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore e lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë; b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës/Maturës Shtetërore.

Mbështetur në aktet nënligjore të sipërpërmendura, Fakulteti i Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës ka pranuar aplikime nga të gjitha kategoritë e sipërpërmendura, përgjatë periudhës 21-26 gusht 2017, ku një ndër aplikantët është edhe ankuesja E. Gj. Pas analizimit të aplikimeve nga Komisioni *ad hoc* në nivel fakulteti ka rezultuar se mesatarja e notave të aplikantes E. Gj. ka qenë më e ulët se nota 6 (gjashtë) dhe si rrjedhim Znj. E. Gj. është skualifikuar, duke u shpallur jo fituese. Ndërkohë që, sipas të njëjtit proces përzgjedhjeje, procedurash dhe kriteresh, në Fakultetin e Shkencave Sociale janë shpallur fitues 7 (shtatë) kandidatë nga komuniteti rom dhe egjiptian.

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk iu përgjigj shkresës nr. 982/2, datë 27.10.2017, të Komisionerit.

☐ Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës nr. 133, datë 13.10.2017, së Znj. E. Gj., në zbatim të Urdhërit nr. 167, datë 22.11.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 30.11.2017, u krye inspektim pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

- Gjatë inspektimit të kryer pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, inspektorët e Komisionerit u informuan mbi çështjet që përbënin objekt të urdhërit të inspektimit. Nga verifikimet e kryera rezultoi se për vitin akademik 2017-2018, pranë këtij fakulteti kanë aplikuar 15 aplikantë që i përkasin kategorive të veçanta (tre prej të cilëve kanë aplikuar për 2 degë të këtij fakulteti), të parashikuar në Kreun VI/2, të Udhëzimit nr. 18/2017 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018”. Nga këta, 4 aplikantë i përkasin komunitetit rom, 7 aplikantë i përkasin komunitetit egjiptian, 3 aplikantë i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe 1 aplikant është nga Mali i Zi

(trojet). Nga këta aplikantë, 7 prej tyre janë skualifikuar (2 aplikantë egjiptianë, 3 aplikantë me aftësi të kufizuara dhe 2 aplikantë romë). Tetë aplikantët e tjerë kanë rezultuar fitues (5 aplikantë egjiptianë, 2 aplikantë romë dhe 1 aplikant nga Mali i Zi). Znj. E. Gj. rezulton të jetë skualifikuar për shkak se nota mesatare e saj është 5.55., nën pragun e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 19.04.2017, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”.

☐ Në vijim të inspektimit të kryer, nëpërmjet shkresës nr. 1183, datë 04.12.2017, Komisioneri iu drejtua sërisht Znj. L. N., Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke e rikujtuar për kthim përgjigje të shkresës paraardhëse të Komisionerit, mbi ankesën e Znj. E. Gj..

- Në përgjigje të shkresës nr. 1183, datë 04.12.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj. L. N., Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgoi shkresën nr. 1183/1, datë 15.12.2017.

Në shkresën e sipërpërmendur, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë sqaron se pranimet në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2017-2017, u kryen në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 19.04.2017, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, si dhe të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018”.

Në shkresën e sipërpërmendur vihet në dukje fakti se në pikën 3, të Kreut IV/2 të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018”, parashikohet se: *“Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë kriterin e mesatares së përcaktuar në Vendimin nr. 346, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit, për të cilat aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional”*.

Për sa më sipër, përzgjedhja e programeve të studimit nga kandidatët për studentë, në momentin e aplikimit, është bërë mbështetur në kriteret e sipërcituara. Kandidatët për studentë, të cilët rezultuan fitues, në përfundim të procesit të pranimeve në programet e studimit, për të cilat kishin aplikuar, kanë përmbushur kriterin e notës mesatare dhe kriteret shtesë të miratuara nga IAL-të. Znj. E. Gj. është skualifikuar për shkak se rezulton të ketë notë mesatare 5.55. nën pragun e përcaktuar nga kuadri ligjor në fuqi. Për këtë arsye, ajo nuk mund të regjistrohej në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

Ndër të tjera, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka theksuar faktin se në bazë të kuadrit ligjor ekzistues kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit 2 vjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare. Znj. E. Gj. ka të drejtë të aplikojë, në programet e studimit dy vjeçare me karakter profesional të ofruara nga IAL-të, përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, Komisioneri gjykon se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe disfavorizues, të pretenduar nga ankuesja:

Znj. E. Gj. është një vajzë 21 vjeçare, me aftësi të kufizuara dhe që i përket komunitetit egjiptian. Ajo ka përfunduar arsimin e mesëm dhe ka aplikuar për kuotat për kategoritë e veçanta, të përcaktuara nga Fakulteti i Shkencave Sociale, i Universitetit të Tiranës, për të ndjekur studimet e larta pranë këtij fakulteti, për vitin akademik 2017-2018. Ajo është shpallur jo fituese nga komisioni *ad hoc* i ngritur pranë këtij fakulteti, pasi nota mesatare e saj është nën pragun e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin nr. 346, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”.

Në Kreun VI/2, të Udhëzimit nr. 18/2017, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018” parashikohen me hollësi procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018.

Në pikën 3, të Kreun VI/2, të Udhëzimit të sipërcituar parashikohet shprehimisht: “*Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe*

plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në Vendimin nr. 346, datë 19.04.2017 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018””

Në pikën 2, të Vendimit nr. 346, datë 19.04.2017, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” parashikohet: “*Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë, nota mesatare minimale për t’u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, **të jetë 6 (gjashtë)**”.*

Referuar shkresës nr. 184/7, datë 06.04.2017, Z. Edmond Rapti, Dekan pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, drejtuar Z. M. K., Rektori i Universitetit të Tiranës, rezulton se janë rezervuar 56 kuota studimesh për kategoritë e veçanta, të përcaktuara në Kreun VI/2, të Udhëzimit nr. 18/2017, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017-2018”.

Për kuotat e rezervuara për kategoritë e veçanta kanë aplikuar 15 kandidatë (ndër të cilët edhe ankuesja), 3 prej, të cilëve kanë aplikuar për 2 degë pranë këtij fakulteti. Nga këta, 4 aplikantë i përkasin komunitetit rom, 7 aplikantë i përkasin komunitetit egjiptian, 3 aplikantë i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe 1 aplikant është nga Mali i Zi (trojet).

Përgjatë procesit të përzgjedhjes së aplikantëve, Komisioni *ad hoc* ka skualifikuar edhe 7 (shtatë) kandidatë, për shkak se nuk plotësonin kriterin e notës mesatare të përcaktuar në VKM e sipërpërmendur. Prej tyre, 2 aplikantë i përkasin komunitetit egjiptian, 3 aplikantë i përkasin kategorisë së individëve me aftësi të kufizuara dhe 2 aplikantë që i përkasin komunitetit rom. Në zbatim të dispozitave përkatëse të akteve nënligjore të sipërcituara, duke qenë se nota mesatare e Znj. E. Gj. është 5.55, Komisioni *ad hoc* pranë Fakultetit të Shkencave Sociale e ka skualifikuar ankuesen duke e shpallur jo fituese.

Nga provat e administruara, rezulton se Komisioni *ad hoc* është treguar tepër rigoroz, lidhur me zbatimin e pragut të notës mesatare. Në këtë kontekst, vihet në dukje fakti, se aplikanti R.K. është shpallur jo fitues, pasi nota e tij mesatare rezultoi 5.99, tepër pranë pragut të notës mesatare të përcaktuar në VKM-në e sipërpërmendur. Ndërkohë që, edhe aplikantë të tjerë⁴ që i përkasinin

⁴ Janë skualifikuar aplikantë që kanë patur notë mesatare 5.95 apo 5.85.

kategorive të veçanta, sikurse ankuesja, janë shpallur jo fitues, pasi kanë patur notë mesatare nën notën 6. Për sa më sipër, rezulton se Komisioni ad hoc i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë aplikantët që nuk plotësonin kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikën 2, të Vendimit nr. 346, datë 19.04.2017, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, duke i skualifikuar ata.

Tetë aplikantë kanë rezultuar fitues për të vazhduar studimet pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, pasi plotësonin kriterin e mesatares dhe kriteret e vendosura nga fakulteti. Nga këta, 5 kandidatë fitues i përkasin komunitetit egjiptian, 2 kandidatë fitues i përkasin komunitetit rom dhe 1 kandidat fitues është nga Mali i Zi.

Në nenin 17, pika 2 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet: *“Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”*. Në rastin konkret, Znj. E. Gj. nuk i është refuzuar pranimi për të studiuar pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, për shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të ligjit të sipërpërmendur, por sepse nuk plotësonte kriterin e notës mesatare mbi 6, të parashikuar nga Vendimi nr. 346, datë 19.04.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Znj. E. Gj. nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, pasi ankuesja nuk plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar në një akt normativ, të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe dispozitat e këtij akti janë zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë aplikantët që i përkisnin kategorive të veçanta.

☐ Në shkresën nr. 1183, datë 04.12.2017, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar Znj. L. N., Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë theksohej i nënvizuar fakti, se Znj. E. Gj. dhe nëna e saj pretendonin se kishin dërguar 2 ankesa pranë këtij institucioni, por Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk i kishte kthyer asnjëherë përgjigje zyrtare as ankueses e as nënës së saj. Në shkresën nr. 1183/1, datë 15.12.2017, të këtij institucioni drejtuar Komisionerit, në asnjë moment nuk kundërshtohet fakti se Znj. E. Gj. kanë dërguar ankesa, por gjithashtu nuk jepet asnjë sqarim, përse nuk i është dërguar ankueses dhe nënës së saj përgjigje zyrtare, duke e anashkaluar këtë fakt. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka detyrim ligjor t’u kthejë përgjigje zyrtare ankuesve,

detyrim, të cilin nuk e ka zbatuar. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e ka ekspozuar ankuesen para një trajtimi të padrejtë, e disfavorizues.

II. Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja.

Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të racës (egjiptiane), aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

“Raca”, “aftësia e kufizuar” dhe “përkatësia në një grup të veçantë” janë disa prej shkaqeve, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ, rezulton se:

☐ Lidhur me pretendimin e Znj. E. Gj. për diskriminim për shkak të “racës” dhe “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e këtij institucioni, për shkak se i përket komunitetit egjiptian. Aktet nënligjore të miratuara përmbajnë rregulla dhe parashikime njëloj të zbatueshme për të gjithë aplikantët që i përkasin kategorive të veçanta, përfshirë këtu anëtarët e komunitetit egjiptian edhe më gjerë. Kriteri i notës mesatare është kriter, i cili vlen si për aplikantët e kategorive të veçanta ashtu edhe për aplikantët e tjerë jashtë tyre. I njëjti argument vlen edhe për pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” nga ana e këtij institucioni.

Komisioneri thekson faktin se nuk disponon fakte dhe prova që moskthimi i përgjigjeve zyrtare nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndaj ankesave të ankueses dhe nënës së saj, të ketë ndodhur për shkak, se ankuesja i përket komunitetit egjiptian apo kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.

- Lidhur me pretendimin e Znj. E. Gj. për diskriminim për shkak të “racës” dhe aftësisë së kufizuar”, nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, Komisioneri vë në dukje faktin, se përgjatë procesit të përzgjedhjes së aplikantëve të kategorive të veçanta, 5 prej fituesve i përkasin komunitetit egjiptian, ndërkohë që 2 prej kandidatëve të skualifikuar sërish i përkasin komunitetit egjiptian. Nga 3 kandidatë me aftësi të kufizuara,

që të tre janë skualifikuar për mosplotësim të kriterit të notës mesatare nga Komisioni *ad hoc*. Në këtë kontekst, Komisioneri vë në dukje faktin se persona/aplikantë të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të ankuesen, janë trajtuar njëjloj me të. Në këto kushte Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi para diskriminimit të ankueses për shkak të racës (egjiptiane) dhe aftësisë së kufizuar.

- Lidhur me pretendimin e Znj. E. Gj. për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, Komisioni gjykon se ankuesja nuk e ka sqaruar në ankesën e saj, se cilit grup i përket ajo, përveç kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe komunitetit egjiptian. Për këtë arsye, Komisioneri nuk e merr në shqyrtim këtë shkak diskriminimi të pretenduar nga ankuesja.

Pas analizës së sipërpërmendur, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e mosdiskriminimit për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar, të ankueses E. Gj., nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

III. Lidhur me justifikimin e subjekteve, ndaj të cilëve drejtohet ankesa, Komisioneri gjykon se:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka theksuar faktin se në bazë të kuadrit ligjor ekzistues⁵ kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit 2 vjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare. Znj. E. Gj. ka të drejtë të aplikojë, në programet e studimit dy vjeçare me karakter profesional të ofruara nga IAL-të, përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas informacionit të administruar rezulton se pranë Fakultetit të Shkencave Sociale nuk ka program studimi 2 vjeçare, por këto programe aplikohen në fakultete të tjera.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 17, pika 2, neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Referuar pikës 3, të Vendimit nr. 346, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018".

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës (egjiptiane) dhe aftësisë së kufizuar të Znj. E. Gj., nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.
- 2.** Rekomandohet që për vitin akademik 2018-2019, Znj. E. Gj. të aplikojë në programet e studimit dy vjeçare me karakter profesional të ofruara nga IAL-të.
- 3.** Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

KOMISIONER

(Shkak: raca & aftësia e kufizuar
Fusha: Arsim)